



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:069900

Datë: 04.03.2021

Numri i dokumentit: 01579989

C.nr.981/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, me gjyqtarin Bekim Salihu, në çështjen juridike të paditësit A.B, me nr.personal ”...”, të cilën me autorizim e përfaqëson me autorizim av. Leutrim Ademi nga Mitrovica, kundër të paditurës Universiteti i Shkencave të Aplikuara – Ferizaj, me seli rruga “Rexhep Bislimi” p.nr., të cilën me autorizim e përfaqëson Armend Hysa, në çështjen juridike për kompensimin e shujtës ditore, në prani të autorizuarit të paditësit dhe në prani të autorizuarit të paditurës, në seancën e mbajtur me datën 10.02.2021 mori, ndërsa përpiloi me 04.03.2021, këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET, në tërësi kërkesëpadia e paditësit A.B. nga Ferizaj, si e bazuar.

II.DETYROHET e paditura Universiteti i Shkencave të Aplikuara - Ferizaj, që paditësit Agron Bajraktari, në emër të shpenzimeve të ushqimit, gjatë ditëve të pranisë në punë për periudhën kohore prej 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, gjithsejtë 633 ditë në punë nga 2 (dy) euro në ditë, t’ia paguaj shumën totale **1.266€ (njëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro)**, me kamat ligjore prej 8% nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 260€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paditësi me datë 16.06.2020, përmes të autorizuarit të tij, av. Leutrim Ademi, ka ushtruar padi për kompensimin e shujtës ditore, për periudhën kohore prej 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij gjatë seancës gjyqësore si dhe fjalës përfundimtare ka deklaruar: Mbesim në tërësi pranë padisë dhe precizimit të kërkesëpadisë duke kërkuar nga gjykata që të njëjtën ta aprovoj në tërësi si të bazuar, përgjigjen në padi e konsiderojmë si të pabazuar dhe në kundërshtim me dispozitat e kontratës kolektive të arsimit të dt. 18.04.2017 duke pasur parasysh se dispozitat e kësaj kontrate kolektive gjejnë zbatim edhe tek palët ndërgjyqëse dhe njëherit ta detyroj të paditurën që të bart shpenzimet procedurale si në precizim të kërkesëpadisë.

E paditura përmes të autorizuarit të saj gjatë seancës gjyqësore si dhe fjalës përfundimtare ka deklaruar: se mbesim edhe më tutje pranë përgjigjes në padi duke kontestuar

në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke shtuar se këshilli drejtues i Universitetit ka refuzuar kërkesën e sindikatës për kompensim të shujtave për shkak se Universiteti në buxhet nuk ka pasur mjete të destinuara për këtë kategori andaj kërkojmë nga gjykata që padinë e paditësit ta hedhë poshtë si të pabazë dhe të vërtetoj vendimin Këshillit drejtues, nr. "...", të dt. 02.03.2020

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve ka bërë administrimin e provave si vijojnë: ka lexuar kontratën e punës me numër protokollit "...", të dt. 07.10.2016 nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj në emër të A.B, vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë, në emër të A.B, me nr. Prot. "...", të dt. 20.11.2020, kërkesën drejtuar Këshillit Drejtues USHAF me nr. prot. "...", të dt. 28.02.2020 dhe vendimi i Këshillit Drejtues të USHAF me nr. prot. "...", të dt. 02.03.2020.

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk ishte kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura nga data 18.04.2017, kur dhe ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive deri me datën 11.03.2020.

Gjykata përmes kontratës së punës e cila është administruar, ka vërtetuar faktin se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadiës është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 të kësaj kontrate, përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive, e që në rastin konkret paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që i njëjti përfiton nga kjo kontratë për faktin se për periudhën nga data 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, ka qenë në vendin e punës respektivisht prezenca e tij në vendin e punës, i cili fakt është vërtetuar përmes listës të ditëve të punës, të lëshuar nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, andaj sipas nenit 35 par.7 është paraparë që të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë, për një ditë pune, shuma prej 2 euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, andaj gjykata sa i përket aprovimit të lartësisë kërkesëpadiës në lidhje me ushqimin e ka bazuar duke e llogaritur ditët e pranisë në punë të paditësit e duke e shumëzuar me 2 euro, për secilën ditë të pranisë së tij në vendin e punës e cila e drejtë buron po nga e njëjta kontratë kolektive.

Nga leximi i kontratës së punës me nr.prot. 541/16, e datës 07.10.2016, gjykata ka konstatuar se paditësi është në marrëdhënie pune edhe tani tek e paditura si profesor i rregullt.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë dhe përcaktimit të lartësisë për shujtën ditore në shumën prej 2 € në ditë, e cila i ka bazuar paditësit duke bazuar në kontratën kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët me date 18.04.2017.

Andaj duke u nisur nga dispozitat ligjore të cekura më lartë të kontratës kolektive, si dhe gjendjes së vërtetuar faktike, gjykata ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka detyruar të paditurën, që paditësit t'i paguaj shumën e specifikuar si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e administruara e të cilat nuk kanë qenë kontestuese nga e paditura, është vërtetuar fakti se paditësi A.B, për periudhën nga data 18.04.2017 deri me 11.03.2020, ka qenë në vendin e punës në periudhë prej 633 ditë, kurse e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e saj siç e ka pasur detyrim nga kontrata kolektive e datës 18.04.2017, sa përket mjeteve buxhetore për ushqim të cekura më lartë.

Sa i për ketë pretendimit të përfaqësuesit të paditurës se kërkesëpadia e paditësit duhet të hudhet poshtë për faktin se e paditura nuk ka mjete financiare që t'i përmbushë këto detyrime ndaj paditësit, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 2 të kësaj kontrate, të gjithë Këshillat Drejtues të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive dhe të planifikojë buxhetin me kohë për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuara për këto raste, andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësi.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata duke u bazuar në nenin 452 par 1 të LPK-së e ka obliguar të paditurën, që paditësit t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 260€ dhe atë për përpilim të padisë shumën prej 104€, taksën gjyqësore për padi në shumë 21€, dhe për përfaqësim të avokatit në një seancë 135€.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.981/20 me datë 04.03.2021

Gjyqtari,
Bekim Salihu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.